



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCEVE
MINISTRI

Nr. 17535 Prot.

Tiranë, më 23/12 / 2024

UDHËZIM

Nr. 15 Datë 23/12 2024

“PËR DISA NDRYSHIME NË UDHËZIMIN NR.11, DATË 17.04.2018 “PËR RREGULLAT E BRENDSHME MBI MËNYRËN E EKZEKUTIMIT TË VENDIMEVE GJYQËSORE TË MINISTRISË SË FINANCEVE DHE EKONOMISË”

Në mbështetje të nenit 102, pika 4 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të neneve 510, 589, të ligjit nr.8116, datë 29.3.1996, “Kodi i Procedurës Civile të Republikës së Shqipërisë” të neneve 43, 54 të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe në zbatim të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin” i ndryshuar, dhe të ligjit nr.152, datë 30.5.2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, Ministri i Financave,

UDHËZON:

Në udhëzimin nr.11, datë 17.04.2018 “Për rregullat e brendshme mbi mënyrën e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë”, bëhen ndryshimet si më poshtë :

1. Në titullin e udhëzimit, togfjalëshi “Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë” zëvendësohet me togfjalëshin “ministrisë përgjegjëse për financat”.
2. Në pikën 6, të Kreut II, togfjalëshi “çështje të pronës publike dhe”, hiqet.
3. Pika 8, e Kreut II, ndryshon si më poshtë vijon:

“8. Struktura përgjegjëse për financat, pas marrjes së dokumentacionit nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore së bashku me kërkesën e miratuar për ekzekutimin e vendimit gjyqësorë, bën verifikimin e fondeve buxhetore dhe radhës së pagesës, sipas data bazës të përcjellë nga struktura përgjegjëse për ndjekjen e çështjeve gjyqësore, dhe i paraqet nëpunësit autorizues propozimin për miratimin e kërkesës së pagesës që shoqërohet me aktin financiar, në kuadër të ekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë.

4. Në të gjithë përmbajtjen e udhëzimit, togfjalëshi “Ministria e Financave dhe

Ekonomisë” zëvendësohet me togfjalëshin “*ministra përgjegjëse për financat*”.

5. Në Aneksin 1, “*Gjurma e Auditimit për procedurat e ekzekutimit të vendimeve gjyqësore*”, faqe 3, zëvendësohet me faqen 3, pjesë përbërëse e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

MINISTRI

Petrit Vllaj



